




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
MINISTRI



Nr. 5279 Prot.

Tirane, më 13/12/ 2012

UDHËZIM

Nr. 14 datë 13.12 2012

**MBI KRITERET, QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË LABORATOR VETERINAR  
I AUTORIZUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 121 pika 3 të ligjit nr.10465 datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar,

UDHËZOJ

1. Laboratorët veterinar privat dhe laboratorët veterinar shtetëror të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 119, dhe 120 të ligjit nr. 10465 datë 29.9.2011“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” paraqesin kërkesën për autorizim për kryerjen e analizave laboratorike veterinare zyrtare, pranë Drejtorisë së Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

2. Drejtoria e Shërbimit Veterinar i përcjell Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë kërkesat e paraqitura sipas pikës 1, për kryerjen e vlerësimit të këtyre laboratorëve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kriteret të cilat duhet të plotësohen nga laboratorët e interesuar për t’u autorizuar sipas pikës 1 me lart, janë si vijon:

a) Laboratori të ketë në perberje të tij jo më pak se një mjek veterinar i cili të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune dhe të ketë kryer kualifikimin në fushën e analizës laboratorike në ISUV;

- b) Specialistët dhe teknikët e laboratorit të kenë kryer kualifikimin në fushën e analizës laboratorike në ISUV;
- c) Laboratori të ketë kaluar me sukses teste krahasuese ndërlaboratorike të organizuara nga ISUV, për provat ku kërkon të autorizohet, të paktën një herë në vit;
- d) Të zbatojë metodologji të njëjtë analitike me Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe të miratuar nga ky i fundit;
- e) Të demostrojë zbatimin e praktikave të mira të punës në laborator, të pasqyruar në dokumentacion;
- f) Të garantojnë zbatimin e normave të biosigurisë për testet të cilat realizohen nga laboratori dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës;
- g) Të jenë të akredituara në përputhje me standardet kombëtare;

4. Vlerësimi i laboratorëve për plotësimin e kriterëve të mësipërme bëhet nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në cilësinë e Qendrës Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinare.

5. Pas përfundimit të vlerësimit të bërë mbi plotësimin e kriterëve të mësipërme, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë i dërgon Drejtorisë së Shërbimit Veterinar përfundimet e arritura mbi plotësimin e kriterëve nga laboratorët të cilët kanë paraqitur kërkesën për autorizim.

6. Me propozimin e Drejtorisë së Shërbimit Veterinar, Ministri autorizon laboratorët veterinarë të cilët kanë plotësuar kriteret e mësipërme.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI**

**GENCRULI**

